

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies  
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**TRANSKRIPTI  
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS  
TË MBAJTUR MË 27.4.2007**

**TRANSKRIPT  
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,  
ODRŽANE DANA 27.04.2007. GODINE**

---

*PRILL - APRIL 2007*

## **REND DITE**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 13 prillit 2007,
3. Koha për pyetje të deputetëve,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin e sëmundjeve ngjitetëse dhe
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kimikatet.

## **DNEVNI RED**

1. Usvajanje dnevnog reda,
2. Usvajanje zapisnsika sa plenarnih sednica od 13 aprila 2007.godine,
3. Vreme za poslanička pitanja,
4. Drugo razmatranje Nacrtu zakokna o sprečavanju zaraznih bolesti,
5. Drugo razmatranje Nacrtu zakona o hemikalijama,

## **AGENDA**

1. Approval of the agenda,
2. Approval of the plenary session minutes on 13 April 2007,
3. Time for deputies question,
4. Second reading of the Draft Law on Prevention of infected disease and,
5. Second reading of the Draft Law on chemicals.

## **Seanca plenare u mbajt në sallën e Kuvendit të Kosovës**

**Seancën e kryesoi Xhavit Haliti  
Seanca filloi me punë në orën 10,15**

**KRYESUESI XHAVIT HALITI – Të nderuar deputetë. Mirë se keni ardhur në seancën e sotme të Kuvendit të Kosovës.**

Ju njoftoj që në sallë janë të pranishëm 86 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar me punët.

Njëkohësisht dua t'ju informoj lidhur me rendin e ditës që ka pësuar pak ndryshime me kërkesë të Qeverisë. Komisioni Fakt Mbledhës i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ka takime me Qeverinë dhe kryeministri ka kërkuar që çështja e pyetjeve - pika e rendit të ditës me pyetje të shtyhet për një seancë të ardhshme. Prandaj, mendoj që do ta bëjmë një miratim formal, sepse kështu e kemi situatën.

Konstatojmë që miratohet shtyrja e pikës së 3 të rendit të ditës për seancën e ardhshme. Njëkohësisht dua t'ju përkujtoj që nga Kuvendi i Kosovës, dita e 27 prillit është shpallur si ditë e të pagjeturëve, e martirëve të pagjetur në Kosovë dhe shoqatat të cilat kanë kërkuar që kjo ditë të shënohet kanë dërguar një faliminderim për miratimin e këtij vendimi. Njëkohësisht dua t'ju njoftoj që sot në fshatin Meje bëhet varrosja e 20 martirëve. Në pamundësi që deputetët e Parlamentit të Kosovës të marrin pjesë në varrimin e tyre, ju ftoj që të mbajmë një minutë heshtje.

(Lavdi)

Redin e ditës e keni marrë. Ju kisha lutar që nëse ka vërejtje dikush për rendin e ditës ta marrë fjalën.

Për rendin e ditës e ka kërkuar fjalën Fatmire Mulhaxha – Kollqaku.

**FATMIRE MULHAXHA – KOLLQAKU – Faleminderit z. kryesues. Në emër të Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, propozoj që pika e 4 e rendit të ditës të shtyhet për seancën e parë të radhës, për shkak të disa lëshimeve teknike që i kemi vërejt do të thotë dhe kjo është arsyaja pse ne po propozojmë të shtyhet, sepse duhet shumë kohë të merret për t'i arsyetuar ato lëshime teknike sot.**

**KRYESUESI XHAVIT HALITI – Kërkesa është në emër të Komisionit. Dikush tjetër. Ramadan Kelmendi.**

**RAMADAN KELMENDI – Faleminderit. I nderuari kryesues, të nderuar deputetë. Shtroj pyetjen pasi që është miratimi i rendit të ditës: Cilat janë shkaqet dhe arsyet që nuk është vu në rend të ditës formalizimi në seancën plenare i Grupit Parlamentar të LDD-së? Ju faleminderit.**

**KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit. Zoti deputeti Gjergj Dedaj.**

**GJERGJ DEDAJ** – Faleminderit shumë z. kryesues. Të nderuar kolegë. Unë nuk pajtohem as me këtë rend ditës as që sot të kemi seancë. Mendoj se sot nuk është vetëm dita e të pagjeturve, siç e tha z. kryesues, por sot është Dita e Dëshmorëve dhe Martirëve të Kosovës. Pa dashur me spekulu, mendoj se shumë deputetë ka qenë dashur sot që të jemi në Meje të Gjakovës ku me 27 prill 1999 janë vra në mënyrë mizore, jo zhdukur dhe humbur, siç po thoni ju, por janë ekzekutuar afër 400 shqiptarë civilë të pafajshëm dhe kjo është një Srebrenicë e Kosovës dhe ka qenë dashur që sot Kuvendi të mos ketë seancë, por të gjithë deputetët, ata që kanë mundësi të jemi atje. Dhe për këtë arsy, më lejoni unë do ta lëshoj seancën në shenjë revolte që Kuvendi i Kosovës sot zhvillon seancë edhe në këto rrethana, ndërsa Ekipi Fakt Mbledhës ka qenë dashur sot të marrë pjesë sot edhe në Meje dhe të sheh me sy të vet një pjesë të historisë së dhembshme, por krenare të Kosovës. Ju faleminderit shumë.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Ju faleminderit. Kishim fjalën për rendin e ditës. Diskutues të tjera nuk ka.

Kërkesa e Komisionit për Shëndetësi është që të hiqet nga rendi i ditës pika 4. Jeni, të nderuar deputetë, për:

Me votim hiqet, shtyhet për seancën e ardhshme pika 4 e rendit të ditës lidhur me Projektligin për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse.

Zoti Kelmendi, Kryesia ka diskutuar lidhur me grupin në fjalë, Grupin e LDD-së, Grupin Parlamentar. Kemi komunikuar me OSBE-në. Kemi komunikuar me institucionet e tjera, të cilat janë përgjegjëse për këtë punë dhe është në proces të miratimit, me qenë se ju i keni kaluar edhe procedurat formale edhe në OSBE, edhe në të gjitha institucionet, besoj që në seancën e ardhshme do të miratohet. Me qenë se në rend dite nuk është futur nga Kryesia, shpresoj që në mbledhjen e ardhshme do të jetë në Kuvend për t'u miratuar edhe formalisht Grupi Parlamentar në fjalë.

Fjalën e ka kërkuar Lulzim Zeneli.

**LULZIM ZENELI** – Z. kryesues. Me keqardhje konstatoj se atë çka u theksua nga ana juaj mund të jetë një keqkuptim apo një keqinterpretim apo një mosfunkcionim i komunikimit në mes anëtarëve të Kryesisë apo edhe vetë administratës të Kuvendit.

Kryesia e Kuvendit ka dhënë një përgjigje për krijimin e Grupit Parlamentar të LDD-së, të bazuar në të gjitha normat dhe përgjigjen që e ka dhënë organi i OSBE-së, organi kompetent. Mirëpo, forma që po procedohet në vazhdim dhe zhagjtja dhe prolongimi i kësaj çështje në një sistem demokratik që funksionon në bazë të parimeve, do të ishte skandaloz dhe do të duhej dhënë përgjegjësi pse ndodh kjo. Një çështje e tillë që po ndodh, deri më tash nuk ka ndodh asnjëherë në praktikat parlamentare së paku në këtë Kuvend. Prandaj, kërkojmë që kjo çështje këtu të vihet në rend sot, të procedohet për vetë faktin që kemi të bëjmë me një formalizim, me një njoftim që më tutje të ecën me procedura të tjera. Kryesia e Kuvendit ka dhënë përgjigje shefit të Grupit Parlamentar të LDD-së z. Ramadan Kelmendit për krijimin e Grupit Parlamentar dhe kjo çështje si sot të mos vihet në rend ditës thjesht kjo konsiderohet edhe si tendencë e mëtejme për zhagjtjen e këtij procesi. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Nuk e kam për qëllim që të kundërshtoj, as nuk ka qenë mendoj deri tash Kryesia ajo që e ka penguar, absolutisht është diskutuar dhe nuk ka

kërkush, të paktën të jem i sinqertë që nga anëtarët e Kryesë askush nuk e ka vënë në dyshim dhe askush nuk ka pasur tendencë që të veprojë në përputhje me ato që i deklaruat më herët.

Kemi pasur dy probleme me të cilat jemi ballafaquar si Kryesi.

Një grup parlamentar të ri në Kuvendin e Kosovës për ta krijuar sipas ligjeve në fuqi, sipas Kornizës Kushtetuese dhe sipas Rregullores askush nuk mund ta ndalojë, së cili 5-6 vetë që mund të bëhen bashkë mund ta shpallin Grupin Parlamentar pa problem dhe detyrë e këtij grapi parlamentar është që t'ia paraqes me shkrim programin politik të Grupit Parlamentar dhe qëllimet e kriimit të këtij grapi parlamentar. Tani me qenë se Grupi juaj parlamentar është grup i një partie të re, e cila është miratuar nga OSBE-ja, ne i kemi marrë disa vërejtje që a mund të quhet Grupi Parlamentar me emrin të cilin e keni propozuar ju. akoma pa u miratuar partia në OSBE? Kjo ka qenë në njëfarë forme pengesa dhe dyshimi se si duhet të veprojmë. Ta pranojmë Grupin Parlamentar të LDD-së, pa u miratuar atje, ndoshta kjo ka qenë një ndër arsyet që është shty. Unë mendoj që Kryesia, dhe asnjëri nga, as kryetari dhe asnjëri nga kryesuesit e seancave nuk ia ka kufizuar të drejtën e as të kryesuesit të Grupit Parlamentar dhe as juve që të shprehni mendimet politike për këtë çështje. Prandaj, unë nuk e kam për qëllim që të polemizoj e as të kundërshtoj. Qëllimi është i mirë mendoj edhe i Kryesisë dhe i të gjithë neve, ta shtyjmë për seancën e ardhshme dhe besoj që në seancën e ardhshme edhe ju do t'i kryeni formalitetet që duhet t'i kryeni në raport me Rregulloren e Kuvendit. Ju faleminderit.

Vazhdojmë, kemi si pikë të dytë të rendit të ditës

## 2. Miratimin e procesverbalit të seancës plenare të 13 prillit 2007

Procesverbal i seancës plenare të datës 13 prill 2007 u është shpërndarë të gjithë deputetëve, Pyes deputetët se a kanë vërejtje në këtë procesverbal?

Nuk ka vërejtje. A miratohet?

Nuk ka vërejtje. Konstatoj që procesverbal i seancës plenare të datës 13 prill 2007 miratohet me shumicën e votave.

Pika e katërt e rendit të ditës është shtyrë për seancën e ardhshme.

Vazhdojmë me pikën e 5 të rendit të ditës që është

## 6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kimikatet.

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 11 janar 2007. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet si vijon:

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për kimikate ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për kimikate dhe amendamentet e propozuara nuk përbëjnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për kemikate dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore, Komisioni për Bujqësi Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si dhe Komisioni Funksional dhe Raportues ka bërë rekomandimet dhe amendamentet në tekstin e Projektligjit për kimikatet si vijon:

Amandamenti i parë  
Hydajet Hyseni ka fjalën.

**HYDAJET HYSENI** – Faleminderit z. kryesues. Më lejoni ,të nderuar deputetë, që në funksion të saktësimit të metodologjisë ligjvënëse të shtroj një çështje. Në materialin përcjellës që është shpërndarë bashkë me Propozim ligjin, është bashkangjitur edhe deklarata e Agjensionit për Integrime Evropiane, e cila shprehimisht thotë se konsiderojmë se Projektligji për kimikate nuk është në përputhje të plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Rekomandojmë që të merren për bazë të gjitha rekomandimet e bëra në kuadër të opinionit ligjor. Ne deputetët as komisionet nuk e kemi marrë këtë relacion, aq më tepër nuk janë marrë rekomandimet. E marrë me mend që komisioni mund t'i ketë inkorporuar ato. Megjithatë e konsideroj të nevojshme që ne të mos e lëmë të paqartë këtë çështje, prandaj do të ishte mirë dhe unë kërkoj që përfaqësuesit e Komisionit të sqarojnë Kuvendin a janë inkorporuar vërejtjet e Agjensionit për Integrime Evropiane, që të mos kemi nevojë edhe njëherë t'i kthehem për t'i riharmonizuar ato. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Faleminderit. Unë të paktën zyrtarisht kam procedurën , e cila ka kaluar nëpër të gjitha komisionet dhe tani komisioni në fjalë nuk po e kërkon fjalën.

Ne po vazhdojmë me votimin e ligjit.

Në sallë janë 89 deputet

Fillojmë me amendamentin e parë.

Votojmë tanë

Për .....	65
Kundër .....	4
Abstenime.....	2

Miratohet amendamenti i parë.

Amendamenti 2

Votojmë tanë:

Për .....	70
Kundër .....	1
Abstenime .....	5

Miratohet amendamenti i dytë.

Amendamenti 3

Votojmë :

Për .....	72
-----------	----

Kundër .....2  
Abstenime .....3  
Miratohet amendamenti i tretë

Amendamenti 4  
Votojmë :  
Për .....65  
Abstenime .....4  
Miratohet amendamenti i katërt

Z. Rifat Krasniq e ka kërkuar fjalën:

Zoti RIFAT KRASNIQ – Z. kryesues, faleminderit, vetëm desha të ma jepni fjalën para votimit, sepse e kam një vërejtje këtu.

Amendamenti 4 në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë. të nenin 2, paragrafi 2, pika (b) viza e dytë në fund duhet shtuar fjalia: “dhe mos të magazinohet”, sepse është pjesë e logjikshme përbërëse e fjalës, por nuk figuron.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Unë ju kërkoj falje, por unë ju kisha lut gjithë deputetëve që keni vërejtje për amendamentet të paraqiteni më kohë dhe të mos më qitni në situatë të palakueshme që pasi të votohet amendamenti të diskutojmë lidhur me atë.. Ka një kërkesë deputeti që të shtohet një fjali: “dhe mos të magazinohet” në amendamentin e 4, pika (b), në fund të pasusit.

Jeni që të miratohet? Okej, miratohet edhe kjo fjali që e kërkoi deputeti Pra konstatoj që është miratuar në amendamentin e katërt fjalia dhe mos të magazinohet.

Amendamenti 5

Votojmë tanë:  
Për .....71  
Kundër .....1  
Abstenime .....6  
Miratohet amendamenti i pestë

Amendamenti 6  
Votojmë tanë:  
Për .....64  
Abstenime .....4  
Miratohet amendamenti i gjashtë

Amendamenti 7  
Votojmë :  
Për .....64  
Abstenime .....2  
Miratohet amendamenti i shtatë

Amendamenti 8  
Votojmë tanë:

Për ..... 66

Abstenime ..... 3

Miratohet amendamenti i tetë

Amendamenti 9

Votojmë tani:

Për ..... 63

Kundër ..... 2

Abstenime ..... 4

Miratohet amendamenti 9

Amendamenti 10

Votojmë tani:

Për ..... 69

Abstenime ..... 4

Miratohet amendamenti 10

Amendamenti 11

Votojmë tani:

Për ..... 69

Abstenime ..... 4

Miratohet amendamenti 11

Amendamenti 12

Votojmë tani:

Për ..... 75

Abstenime ..... 3

Miratohet amendamenti 12

Amendamenti 13

Votojmë tani:

Për ..... 67

Abstenime ..... 2

Miratohet amendamenti 13

Amendamenti 14

Votojmë :

Për ..... 69

Abstenime ..... 4

Miratohet amendamenti 14

Amendamenti 15

Votojmë

Për ..... 73

Abstenime ..... 3

Kundër ..... 1

## Miratohet amendamenti 15

### Amendamenti 16

Votojmë tani

Për ..... 61

Kundër ..... 2

Abstenime ..... 6

Miratohet amendamenti 16

### Amendamenti 17

Votojmë :

Për ..... 64

Abstenime ..... 3

Miratohet amendamenti 17

### Amendamenti 18

Votojmë :

Për ..... 72

Abstenime ..... 3

Miratohet amendamenti 18

### Amendamenti 19

Votojmë tani

Për ..... 70

Abstenime ..... 1

Miratohet amendamenti 19

Rifat Krasniq e ka fjalën për amendamentin 20 .

DEPUTETI RIFAT KRASNIQ – Ju faleminderit z. kryesues . Te amendamenti 20, sipas pajtimit të Komisionit në mbledhjen e fundit, Komisioni te neni 27, paragrafi b) duhet të shtohet fjalët: Në bashkëpunim dhe në asistencën me doganoret; duhet të shtohet. Tani vazhdon, ndalohet kalimi i transkriptit:

KRYESUESI XHAVIT HALITI – A jeni dakord me propozimin e ? Ia shtojmë edhe këtë. Miratojmë amendamentin e 20, votojmë tani.

### Amendamenti 20

Për ..... 53

Kundër ..... 1

Abstenim ..... 1

Miratohet amendamenti 20

### Amendamenti 21

Votojmë tani

Për .....68  
Kundër..... 1  
Miratohet amendamenti 21

Amendamenti 22  
Votojmë tani  
Për .....68  
Kundër..... 1  
Abstenime..... 2  
Miratohet amendamenti 22

Amendamenti 23  
Votojmë :  
Për .....68  
Abstenime..... 3  
Miratohet amendamenti 23

Amendamenti 24  
Votojmë :  
Për .....68  
Kundër..... 1  
Abstenime..... 2  
Miratohet amendamenti 24

Amendamenti 25  
Votojmë :  
Për .....65  
Kundër..... 1  
Abstenime..... 2  
Miratohet amendamenti 25

Konstatoj që amendamentet janë votuar dhe tani lus deputetët që të deklarohen për tekstin në tërësi të Projektligjit për ndryshimet e bëra.  
Në sallë janë 93 deputë.

Votojmë tani:  
Për .....77  
Abstenim ..... 2  
Konstatoj që Projektligji është miratuar dhe njëkohësisht ju njoftoj që seanca e sotme përfundoj.

**Mirë u pafshim në seancën e ardhshme.**